



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
Ministarstvo Rada i Socijalne Zastine – Ministry of Labour and Social Welfare

10.09.2020, Prishtinë

FTESË PËR APLIKIM

për anëtarë të Komisionit Vlerësues për projektet e OJQ-ve në fushën e shërbimeve sociale, aftësimit profesional, punësimit, pensione dhe zhvillimit të aktiviteteve të promovimit për të drejta sociale për grupet e cënueshme

Bazuar në Rregulloren e Ministrisë së Financave Nr. 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, në Nenin 8, paragrafin 3.2 parasheh që pjesë e çdo Komisioni Vlerësues për vlerësimin e projektpropozimeve të OJQ-ve të pranuar sipas thirrjes publike, duhet të jenë dy përfaqësues nga grupi i ekspertëve të jashtëm, duke përfshirë një përfaqësues të OJQ-ve.

Për këtë qëllim MPMS-ja fton të gjithë të interesuarit që të aplikojnë për të qenë pjesë në cilësinë e anëtarit të Komisionit Vlerësues për të vlerësuar projektpropozimet e dorëzuara nga OJQ-të, sipas thirrjes publike në fushën e shërbimeve sociale, aftësimit profesional, punësimit, pensione dhe zhvillimit të aktiviteteve të promovimit për të drejta sociale për grupet e cënueshme të datës 10.09.2020, të publikuar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale.

Të gjithë kandidatët të cilët nuk janë nën hetime apo me precedent penal dhe që kanë përvojë në shoqëri civile me përparësi nga OJQ-të që merren me fushën e shërbimeve sociale, punësimin, aftësimin profesional apo pensionet, iu mundësohet të aplikojnë për pjesëmarrje në Komisionin Vlerësues në cilësi të:

- Një përfaqësuesi nga OJQ-të;
- Një përfaqësuesi në cilësinë e ekspertit.

Të drejtë aplikimi kanë:

- Të punësuarit në organizatat joqeveritare aktive në Republikën e Kosovës;
- Ekspertë të pavarur, të cilët kanë të paktën 5 vite përvojë pune që ndërlidhet me administratën publike, hartimin dhe menaxhimin e projekteve në fushën e shërbimeve sociale, punësimit, aftësimit profesional, pensioneve apo fushave të ngjashme.

Kandidatët duhet të plotësojnë këto kushte:

- Të kenë të kryer së paku nivelin e studimeve Bachelor;
- Të kenë të paktën 5 vite përvojë pune;
- Të kenë përvojë në projektet e OJQ-ve;
- Të mos jenë të emëruar politikë, shërbyes civil apo pozita të ngjashme në administratën shtetërore.

Kandidatët duhet të dorëzojnë këto dokumente:

- Një letër motivimi;
- Një CV të përditësuar;
- Dëshmi për shkollimin dhe përvojën e punës;
- Të punësuarit në OJQ duhet të dorëzojnë një letër nominimi nga udhëheqësi i OJQ-së në të cilën aplikuesi është i punësuar apo angazhuar.

Aplikimi mund të bëhet përmes e-mail: adelina.hasani@rks-gov.net deri më datën 30.09.2020.

Aplikimin mund ta bëni po ashtu, duke dorëzuar një kopje fizike të dokumentacionit të kërkuar në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Sheshi Miss Edit Durham nr.46, pranë Hotelit Grand, 10 000, Prishtinë - Zyra e Personelit në MPMS.

MPMS-ja do të vlerësojë të gjitha aplikacionet e pranuar dhe kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret e përcaktuara përmes kësaj ftese publike do të jenë pjesë e Komisionit Vlerësues të thirrjes publike në fushën e shërbimeve sociale, aftësimit profesional, punësimit, pensioneve dhe zhvillimit të aktiviteteve të promovimit për të drejta sociale për grupet e cënueshme të datës 10.09.2020 të publikuar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale.